




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 3: Statistikat Ekonomike

# Bilanci i Energjisë në Kosovë 2002 - 2008



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo






Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 3: Statistikat Ekonomike

# Bilanci i Energjisë në Kosovë 2002 - 2008



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Qershor 2009

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së  
në internet: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)

## Parathënie

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për prodhimin e thëngjillit, prodhimin e energjisë, konsumin e energjisë, importin e energjie , eksportin e energjisë, importin e naftës dhe gas-it. Ky publikim statistikor paraqet një analize statistikore për periudhën 2002-2008.

Burimet e të dhënave të shfrytëzuar janë: Korporata Energjetike e Kosovës dhe shënime nga Statistikat e Tregtisë së Jashtme.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm, dhe në baze të indikatorëve që publikon Eurostat-i për statistika energjetike, kemi prezantuar të dhëna me interes.

Qëllimi i publikimit është të vëre në dukje tendencën e zhvillimit të këtij sektori.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ESK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Për kontributin e dhënë në përgatitjen e këtij publikimi falënderojmë Zj. Milva Ekonomi – konsulentë afatgjate e SCB/SIDA-s në ESK.

Në mënyre të veçantë falënderojmë Korporatën Energjetike të Kosovës pa bashkëpunimin e të cilëve nuk do të ishte i mundur ky publikim.

Ky publikim është fryt i angazhimit dhe punës së stafit të statistikave të energjisë në kuadër të Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare.

Drejtorit të departamentit : z. Ilir T. Berisha, Arlinda Mataj, Nazmije Belegu, Bekim Bojku dhe Sulltane Gashi.

Dizajni: Ahmet Cakolli

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim i konsiderojmë të mirëseardhura.

Ueb faqja: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk) ose

E-mail adresa: [economic@ks-gov.net](mailto:economic@ks-gov.net)

Qershor 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,  
Z. Avni Kastrati

## Lista e Shkurtesave

- ESK** – Enti i Statistikes së Kosovës
- KEK** – Korporata Energjetike e Kosoves
- MTI** – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- SCB** – Statistical Central Byro
- SIDA** – Sweden International Development Agency
- TC** - termocentral
- HC** - hidrocentral
- GWh** - Giga wat për ore (njësi matëse e energjisë)
- t** - Tonelatë (njësi matëse për peshe)

## Përmbajtja

	Faqe
1 Prodhimi i thëngjillit .....	6
2 Prodhimi i energjisë.....	8
3 Konsumi .....	10
4 Konsumi Komercial .....	12
5 Humbjet.....	14
6 Eksporti dhe Importi i Energjisë .....	15
7 Importi i Gaz-it.....	17
8 Importi i Naftës dhe derivateve të saja ( benzina).....	19
9 Eksporti i energjisë .....	21
10 Prodhimi importi dhe humbjet e energjisë elektrike.....	23
11 Hidrocentralet .....	24
12 KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës).....	27



## **H y r j e**

Prodhimi i energjisë bazohet kryesisht në : energji që lirohet nga thëngjilli (linjit) dhe uji. Prodhimi i energjisë nga linjitet realizohet nga Termo Centralet (TC) që në Kosovë janë dy: TC Kosova A dhe TC Kosova B. Prodhimi i energjisë nga uji (Hidrocentral - HC) në Kosove realizohet nga tre: HC i Radavcit, HC Ujmanit dhe HC i Lumbardhit. E gjithë sasia e prodhuar menaxhohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK –u) e cila është korporata më e rëndësishme e burimeve energjetike në Kosovë. Gjatë viteve të fundit kjo korporatë është ndeshur me shume vështirësi. Pas konfliktit është konstatuar se janë dëmtuar apo djegur mbi 65 000 njehsorë elektrikë.

## 1 Prodhimi i thëngjillit

Kosova është mjaftë e pasur me thëngjill. Aktualisht janë dy miniera ku bëhet nxjerrja e thëngjillit : miniera e Bardhit dhe miniera e Mirashit. Mesatarisht për vit nxjerrin 6.44 milion ton.


Thëngjilli është lëndë djegëse e ngurtë e cila shërben në termocentrale si lëndë e parë për prodhimi e energjisë elektrike, po ashtu përdoret edhe për ngrohje dhe amvisëri në sektorin privat.

**Tab 1. prodhimi i thëngjillit në (në mijë) ton dhe norma vjetore e rritjes (2002-2008)**

Vitet	Prodhimi i thëngjillit (000 t)	Norma e prodhimit të thëngjillit nga viti në viti (%)
2002	5.527,9	-
2003	6.465,9	16,97%
2004	5.658,4	-12,49%
2005	6.391,1	12,95%
2006	6.532,3	2,21%
2007	6.715,4	2,80%
2008	7.842,0	16,78%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 1. prodhimi i thëngjillit i shprehur në mijë ton për periudhën 2002 deri 2008**



Duke marrë për bazë viti 2002 e gjer në vitin 2008 Kosova gradualisht ka shtuar prodhimin e thëngjillit prej vitit në vite. Mirëpo nëse si bazë merret viti paraprakë atëherë shohim se ka pasur rënie vetëm në vitin 2004. Në 2002 Kosova ka prodhuar 5.52 milion ton ndërsa në vitin 2003 ka prodhuar 6.46 milion ton apo për 16.97% është rritë prodhimi. Për dallim nga vitet e tjera ku prodhimi është rritë prej vitit në vite, në vitin 2004 kemi një rënie për 12.49% apo 807.57 mijë ton ku gjithsej në vitin 2004 janë prodhuar 5.65 milion ton. Në vitin 2005 kemi të prodhuar 6.39 milion ton 12.95% më shumë se vitin 2004.

Në vitin 2006 janë prodhuar 6.53 milion ton, apo 2.21% më shumë se në vitin 2005. Në vitin 2007 janë prodhuar 6.71 milion ton, apo 2.8% më shumë se vitin 2006, dhe vitin 2008 janë prodhuar 7.84 milion ton apo 16.78%. më shumë se në vitin 2007.

**Tab 1a. Prodhimi i thëngjillit në baza mujore i shprehur në (në mijë) ton (2002-2008)**

Vitet	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		614,9	729,0	535,6	591,7	573,7	518,7	342,3	457,5	281,2	217,6	246,8	418,9	5527,9
2003		527,8	496,0	571,9	512,5	657,6	560,2	374,0	594,3	440,8	486,3	584,0	660,5	6465,9
2004		620,0	582,5	656,6	439,9	373,5	404,4	383,8	379,6	339,5	379,3	444,2	655,0	5658,4
2005		568,2	607,5	604,7	670,7	428,8	469,8	385,7	435,7	652,2	613,9	412,5	541,4	6391,1
2006		554,9	714,4	495,0	448,6	485,4	337,5	431,5	435,0	707,1	535,9	631,6	755,5	6532,3
2007		617,2	741,1	669,7	460,0	414,4	624,0	533,0	496,9	440,0	461,8	505,8	751,5	6715,4
2008		772,8	697,8	621,9	579,2	481,5	545,1	506,7	572,0	534,5	1049,3	773,2	708,0	7842,0

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Ndërsa nëse merret pika më e ultë dhe më e lartë e prodhimit të thëngjillit shihet se:

- në tetorin e 2002 është prodhuar më së paku thëngjill ndërsa ,
- më së shumti thëngjill është prodhuar në tetor të 2008 .

## 2 Prodhimi i energjisë

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u) është kompania e vetme që prodhon energji elektrike.


Mesatarja vjetore e prodhimit të energjisë elektrike nga thëngjilli është 3.80 milion GWh.

**Tab 2. Prodhimi i energjisë i shprehur në GWh dhe norma e rritjes prej vitit në vit**

Vitet	Prodhimi i energjisë në prag të TC dhe HC Ujman GWh	Norma e prodhimit të energjisë nga viti në viti (%)
2002	3.151,80	-
2003	3.221,00	2,20%
2004	3.481,10	8,07%
2005	3.999,80	14,90%
2006	3.970,50	-0,73%
2007	4.309,40	8,54%
2008	4.505,70	4,55%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 2. Prodhimi i energjisë elektrike nga TC dhe HC Ujman i shprehur në GWh**



Nga të dhënat e tabelës më sipërme shohim se në Kosovë kemi rritje të prodhimit nga viti në viti, me përjashtim të vitit 2006. Po ashtu kemi rritje të prodhimit të energjisë edhe nëse si bazë merret viti 2002.

Në vitin 2002 kemi të prodhuara 3,151.8 GWh. Në vitin 2003 kemi të prodhuara 3,221.0 GWh apo 2.19 %, më shumë se në vitin 2002. Në vitin 2004 janë të prodhuara 3,481.1 GWh, apo 8.07% se vitin 2003. Në vitin 2005 janë prodhuar afërsisht 3,999.8 GWh, apo 14.9% më shumë se vitin 2004, ndërsa në vitin 2006 janë të prodhuara 3,970.5 GWh, apo 0.73%, më pakë se vitin 2005. Në vitin 2007 janë prodhuar 4,309.4 GWh, apo 8.53% më shumë se në vitin 2006. Në vitin 2008 janë prodhuar 4,505.7 GWh, apo 4.50%.

**Tab 2a. Prodhimi i energjisë elektrike në baza mujore i shprehur në GWh  
(2002-2008)**

Vitet	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		424,0	342,0	367,4	426,7	359,6	359,7	210,3	136,5	75,2	89,5	113,1	247,7	<b>3.152</b>
2003		285,1	306,7	298,7	273,1	310,9	286,9	246,8	209,1	187,6	237,2	290,7	288,3	<b>3.221</b>
2004		314,2	334,4	325,7	290,9	247,1	219,1	253,8	245,6	162,2	360,4	330,5	397,2	<b>3.481</b>
2005		428,9	389,0	381,3	329,0	256,5	282,5	289,4	241,7	241,7	318,0	392,2	449,3	<b>4.000</b>
2006		437,3	337,5	386,9	289,5	246,8	231,6	350,6	281,5	287,9	276,5	397,9	446,5	<b>3.971</b>
2007		433,9	378,1	393,8	372,2	424,2	351,8	266,7	280,7	162,8	313,5	440,5	491,3	<b>4.309</b>
2008		452,9	369,1	423,0	374,1	316,0	302,1	354,8	275,4	371,6	409,3	424,3	433,2	<b>4.506</b>

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Pikatë më kritike të prodhimit të energjisë janë ato në muaji gushtë dhe shtator, ndërsa minimumi i prodhimit ka qenë në shtator të 2002 ku ka prodhuar afërsisht 75.20 GWh. Ndërsa pika maksimale e prodhimit të energjisë është shënuar në dhjetorë të vitit 2007

### 3 Konsumi

I tërë prodhimi i energjisë konsumohet për amvisëri, biznes dhe një pjesë humbet. Raporti i konsumit të përgjithshëm të energjisë se konsumuar përbehet rreth 66.14 % për amvisëri dhe rreth 33.86% për biznese. Kjo do të thotë se konsumi i amvisërisë përben një përqindje më të madhe.

#### Konsumi nga Amvisëritë


Konsumi i amvisërisë-paraqet sasinë e energjisë elektrike të konsumuar nga ekonomit familjare. Konsumi i energjisë për amvisëri nga viti 2002-2008 shihet në tabelën nr 3.

**Tab. 3 Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë dhe norma e konsumit të energjisë nga vit në vit (2002-2008)**

Vitet	Konsumi i energjisë nga amvisëritë GWh	Norma e konsumit në amvisëri të energjisë nga viti në vit (%)
2002	1.409,20	-
2003	1.426,40	1,22%
2004	1.490,00	4,46%
2005	1.447,90	2,83%
2006	1.458,60	0,74%
2007	1.503,50	3,08%
2008	1.666,90	10,87%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 3. Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë në GWh (2002-2008)**



Sektori i amvisërisë harxhon mesatarisht 39.10% të energjisë së prodhuar apo 33.56% të energjisë së siguruar<sup>1</sup>.

Mesatarja vjetore e sasisë së konsumuar të energjisë elektrike për amvisëri nga viti 2002-2008 është 1,486.0 GWh.

Konsumi për amvisni ka pasur një rritje graduale prej vitit 2002 deri në vitin 2006 viti 2007 ka shënuar një rritje, por trendi i rritjes dukshëm vërehet në vitin 2008 .

Në vitin 2002 konsumi për amvisni ka qenë 1,409.2 GWh, ndërsa në vitin 2003 konsumi për amvisëri ka qenë 1,426.4 GWh, ose 1.22% më shumë se në vitin 2002. Në vitin 2004 konsumi për amvisëri ka qenë rrethë 1,490.0 GWh, apo 4.46% më shumë se në vitin paraprak. Konsumi për amvisni në vitin 2005 ka qenë 1,447.9 GWh apo 2.83% më pakë se në vitin 2004. Në vitin 2006 konsumi për amvisëri ka pasur një rritje prej 0.74%. ka shifra e përgjithshme ka qenë 1,458.6 GWh. Rritja e konsumit për amvisëri ka filluar të rritë në një nivel më të dukshëm gjatë vitit 2007 shihet një rritje prej 3.08% apo vlera e përgjithshme e kapë shifrën prej 1,503.5 GWh. Mirëpo siç e cekëm edhe më herët rritje të konsumit për amvisni në një nivel prej 10.87% kemi pasur gjatë vitit 2008 vëla e përgjithshme e të cilit është 1,666.9 GWh.

**Tab 3a. Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e amvisërisë në baza mujore në GWh 2002- 2008**

Vitet	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		125,7	116,4	147,2	120,6	116,2	131,0	99,1	96,2	109,2	115,2	113,6	118,7	1409,2
2003		128,7	137,1	120,1	131,9	90,2	101,7	105,4	109,7	108,3	123,2	136,5	133,7	1426,4
2004		146,4	148,0	132,8	126,4	124,6	120,0	102,6	107,1	108,5	111,6	128,9	133,1	1490,0
2005		141,8	143,7	133,8	125,3	121,3	111,0	107,6	98,6	107,8	112,3	119,7	125,0	1447,9
2006		136,2	122,7	143,8	126,0	128,1	123,1	95,0	100,3	116,3	112,5	127,7	126,8	1458,6
2007		141,2	141,5	127,5	125,1	119,4	115,0	113,5	113,3	112,9	113,9	137,5	142,8	1503,5
2008		156,6	160,6	149,5	142,5	132,8	125,3	115,6	121,4	128,4	135,6	141,1	157,6	1666,9

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

<sup>1</sup> Energjia e siguruar perbehet nga ajo e prodhuar ne vend dhe nga energjia e importuar

## 4 Konsumi Komercial


Konsumi komercial -paraqet sasinë e energjisë elektrike të konsumuar nga bizneset.

**Tab 4. Konsumi i energjisë në sektorin komercial dhe norma e konsumit të energjisë nga vit në vit (2002-2008)**

Vitet	Konsumi i energjisë komerciale GWh	Norma e konsumit komercial të energjisë nga viti nëvit (%)
2002	541,4	-
2003	614,6	13,52%
2004	649,2	5,63%
2005	661,5	1,88%
2006	696,5	5,29%
2007	887,9	27,08%
2008	1.274,0	43,87%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 4. Konsumi i energjisë në sektorin komercial në GWh (2002-2008)**



Mesatarja e sasisë së konsumuar të energjisë elektrike për biznese nga viti 2002-2008 është 760 GWh. Sektori i biznesit mesatarisht harxhon 19.99% të energjisë së prodhuar. Ndërsa në vitin 2008 konsumi për sektorin e biznesit ka qenë 28.26% të energjisë së prodhuar apo 24.72% e energjisë së siguruar.

Në vitin 2002 konsumi komercial ka qenë 541.3 GWh, ndërsa në vitin 2003 konsumi komercial ka qenë 614.6 GWh, ose 13.53% më shumë se në vitin 2002. Në vitin 2004 konsumi komercial ka qenë 649.2 GWh, apo 5.63% më shumë se në vitin paraprak. Konsumi komercial në vitin 2005 ka qenë 661.4 GWh apo 1.88% më shumë se në vitin 2004. Në vitin 2006 konsumi komercial ka pas një rritje prej 5.30%. ka shifra e përgjithshme ka qenë 696.5 GWh. Konsumi komercial ka filluar të rritën në një nivel më të dukshëm gjatë vitit 2007 ku shihet një rritje prej 27.47% apo vlera e përgjithshme e kapë shifrën prej 887.8 GWh. Ndërsa rritje të konsumit komercial në një nivel prej 43.49% kemi pasur gjatë vitit 2008 vlera e përgjithshme e të cilit është 1,274.0 GWh.

**Tab 4a. Konsumi komercial i energjisë elektrike në baza mujore në GWh (2002-2008)**

Vitet	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		45,6	48,7	57,0	50,7	49,4	42,6	37,0	29,9	39,2	47,6	47,0	46,6	<b>541,4</b>
2003		51,6	49,0	49,3	51,3	64,9	42,4	48,7	45,9	48,8	49,2	59,6	53,9	<b>614,6</b>
2004		61,0	55,6	61,6	55,6	51,3	48,6	48,4	47,3	48,0	54,3	55,8	61,8	<b>649,2</b>
2005		59,8	58,4	62,5	55,2	50,7	51,7	50,0	51,6	50,6	52,6	59,0	59,4	<b>661,5</b>
2006		59,5	57,0	67,7	59,1	62,0	56,2	49,2	54,7	52,1	50,4	66,2	62,3	<b>696,5</b>
2007		64,7	64,8	65,0	61,7	60,4	61,6	75,1	82,8	82,2	85,7	92,2	91,8	<b>887,9</b>
2008		92,2	98,6	97,3	105,5	108,9	97,6	94,0	117,6	112,7	120,4	121,0	108,2	<b>1274,0</b>

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

## 5 Humbjet


Humbjet e energjisë elektrike- paraqesin atë sasi të energjisë elektrike e cila humbet në rrjet, shpërndarje dhe keqpërdorim.

**Tab 5. Humbjet e energjisë elektrike dhe ndryshimi i humbjeve të energjisë elektrike (2002-2008)**

Vitet	Humbjet e energjisë GWh	Norma e humbjeve të energjisë nga viti nëviti (%)
2002	1.369,00	-
2003	1.539,00	12,42%
2004	1.797,00	16,76%
2005	2.159,10	20,15%
2006	2.127,30	-1,47%
2007	2.205,10	3,66%
2008	1.999,70	-9,31%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 5. Humbjet e energjisë elektrike GWh (2002-2008)**



Mesatarja e vjetore e humbjeve të energjisë elektrike është 1,885.4 GWh. Mesatarisht për periudhën 2002-2008 45.6% e energjisë në dispozicion humbet. Nga viti 2005 deri në vitin 2008 ka tendenca të rënies së shkallës së humbjeve të energjisë elektrike.

## 6 Eksporti dhe Importi i Energjisë

Për periudhën kohore një vjeçare Kosova importon dhe eksporton energji. Bilanci tregtar është negativ, kjo tregon se burimet tona energjetike janë të pa mjaftueshme për nevojat e vendit.

### Importi i energjisë


Importi i energjisë elektrike paraqet atë sasi të energjisë elektrike që blihet jashtë shtetit. Sasia mesatare e importuar e energjisë elektrike është 629.0 GWh.

**Tab 6. Importi i energjisë elektrike dhe ndryshimi i normës së importit të energjisë GWh (2002-2008)**

Vitet	Importi i energjisë (në mijë) GWh	Norma e imp. të energjisë së nga viti në vit (%)
2002	816,0	-
2003	637,3	-21,90%
2004	650,6	2,10%
2005	490,6	-24,59%
2006	537,8	9,61%
2007	623,4	15,91%
2008	647,5	3,86%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 6. Importi i energjisë elektrike në GWh (2002-2008)**



Për periudha të ndryshme kohore brenda intervalit 2002-2008 Kosova ka importuar sasi të ndryshme të energjisë eklektike mirëpo nga të dhënat që kemi në dispozicion e të cilat janë marr nga KEK-u, shihet se kemi një rënie të konsiderueshme të importit, e kur merret parasysh kërkesa për energji elektrike, shohim se gjendja me energji elektrike gradualisht shkon drejt përmirësimit.

Në vitin 2002 Kosova ka importuar 815.9 GWh që ka qen edhe importi më i madhe nga vitit 2002-2008. Në vitin 2003 Kosova ka importuar 637.2 GWh apo 21.9% më pak se në vitin 2002. Në vitin 2004 Kosova ka importuar 650.6 GWh apo 2.10% më shumë se vitin 2003. Në vitin 2005 Kosova ka importuar 490.6 GWh apo 24.59% më pakë se në vitin 2004. Në vitin 2006 importi i energjisë elektrike ka qenë 537.8 GWh ku shihet një ngritje e importit të energjisë për 9.61% në raport me vitin 2005. Në vitin 2007 kemi import të energjisë elektrike prej 623.3 GWh ose 15.91% më shumë se në vitin 2006, edhe një ngritje e vogël e importit vërehet edhe në vitin 2008 në raport me vitin 2007, apo të shprehur në shifra 647.4 GWh ose 3.86% më shumë.

**Tab 6a Importi i energjisë elektrike në baza mujore në GWh (2002-2008)**

Vitet	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		5,2	33,3	33,3	6,1	7,2	1,6	41,7	54,7	150,0	199,7	190,6	92,7	<b>816,0</b>
2003		90,0	49,2	43,1	45,9	7,2	1,5	19,6	28,3	74,7	62,2	70,4	145,2	<b>637,3</b>
2004		153,3	74,5	61,6	35,7	52,3	35,1	6,0	16,7	103,8	15,4	47,6	48,7	<b>650,6</b>
2005		62,6	60,7	62,3	16,4	37,0	25,8	23,3	33,3	48,7	51,7	35,9	33,0	<b>490,6</b>
2006		37,9	66,4	41,0	64,6	72,7	46,7	7,2	28,4	40,7	66,0	27,0	39,3	<b>537,8</b>
2007		58,8	85,8	57,7	20,0	1,7	3,8	34,9	52,6	149,1	93,3	36,1	29,5	<b>623,4</b>
2008		71,7	91,9	39,1	47,1	60,6	10,6	-	53,8	44,6	61,2	63,4	103,6	<b>647,5</b>

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Na tabela 6a. shihet se importi i energjisë elektrike piken maksimale e ka arritur në tetor të 2002 ku ka importuar 199.7 GWh, ndërsa piken minimale e kemi në korrik të 2008 ku edhe shihet se sasia e energjisë është së importuar është 0 GWh.

## Importi i Gaz-it


Gazi natyror është lëndë djegëse e cila përbëhet nga propani dhe butani, përdoret për transport, industri dhe sektorë të tjera.

**Tab 7. Importi i Gazit dhe ndryshimi i importit nga vitit në vit (2004-2008)**

Vitet	Importi i Gaz-it (në mijë)ton	Norma e importit të Gaz-it nga viti në vit (%)
2004	9.057,1	-
2005	13.694,2	51,19%
2006	19.394,7	41,63%
2007	25.208,4	29,96%
2008	31.567,2	25,22%

Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme - ESK

**Graf 7. Importi i Gazit në (në mijë) ton (2004-2008)**



Importi i gazit ka një rritje nga viti në vite, sasia mesatar e importit është nga vitit 2004-2008 është 19.78 milion ton, kurse vitin 2008 importi i gazit ka qenë 31.5 milion ton.

Nga kjo mundë të arrihet deri në përfundim se Gazi në vitet e ardhshme mund të bëhet lënda djegëse më e kërkuar.

Në vitin 2004 kemi pasur të importuar 9.06 milion ton gaz, ndërsa në vitin 2005 kemi të importuar 13.69 milion ton gaz apo 51.20% më shumë se në vitin 2004. Në vitin 2006 kemi përsëri një rritje prej 41.63%, ku vlera e përgjithshme kap shumën 19.39 milion ton gaz. Në vitin 2007 importi i gazit ka qenë 25.20 milion ton, apo 29.98% më shumë se në vitin paraprakë. Edhe në vitin 2008 kemi një ngritje prej 25.22% më shumë se në vitin 2007, vlera e të cilit kapë shifrën 31.56 milion ton gaz.

Tab 7a. Importi i gazit në baza mujore në (në mijë)t (2004-2008)

<b>Vitet</b>	<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>	<b>Prill</b>	<b>Maj</b>	<b>Qershor</b>	<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>	<b>Tetor</b>	<b>Nëntor</b>	<b>Dhjetor</b>	<b>Totali</b>
2004	840,3	594,8	557,5	458,0	487,7	664,3	509,3	954,8	1.136,0	867,4	705,4	1.281,5	<b>9.057,1</b>
2005	1.241,9	1.651,5	668,4	493,6	886,8	784,5	973,1	1.161,2	1.369,0	1.226,2	1.845,0	1.393,0	<b>13.694,2</b>
2006	1.580,9	1.362,1	1.465,5	1.234,7	1.231,0	1.211,8	1.376,7	1.839,9	2.002,9	1.837,1	2.049,9	2.202,4	<b>19.394,7</b>
2007	2.577,8	1.629,1	1.256,2	1.460,3	1.559,6	1.776,2	2.179,9	2.043,0	2.799,4	1.998,4	2.781,7	3.146,8	<b>25.208,4</b>
2008	1.683,1	2.213,1	2.467,3	1.862,8	2.584,8	2.791,1	2.488,0	2.407,0	2.933,3	2.820,8	3.216,5	4.099,5	<b>31.567,2</b>

Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme - ESK

## 7 Importi i Naftës dhe derivateve të saja ( benzina)


Nafta - Është lëndë djegëse e lëngët që përdoret për transport, industri dhe sektorë tjera

**Tab 8. Importi i Naftë dhe derivateve të saja dhe Norma e importit (2004-2008)**

Vitet	Importi i Naftës (në mijë)ton	Norma e importit të Naftës nga viti në vit (%)
2004	363.546,5	-
2005	352.939,6	-2,92%
2006	357.497,4	1,29%
2007	370.962,0	3,77%
2008	422.496,3	13,89%

Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme - ESK

**Graf 8. Importi i Naftë dhe derivateve të saja në (në mijë) ton (2004-2008)**



Importi i naftës dhe derivateve të saja ka qenë konstant nga viti 2004 -2007, një rritje më të dukshme e shohim në vitin 2008, mesatarisht Kosova importon 373.4 milion ton Naftë dhe derivateve të saja.

Në vitin 2004 kemi pasur të importuar 363.54 milion ton , ndërsa në vitin 2005 kemi të importuar 352.93 milion ton naftë apo 2.92% më pakë se në vitin 2004. Në vitin 2006 kemi përsëri një rritje prej 1.29%, ku vlera e përgjithshme kap shumën 357.49 milion ton. Në vitin 2007 importi i naftës ka qenë 370.96 milion ton, apo 3.77% më shumë se në vitin paraprakë. Edhe në vitin 2008 kemi një ngritje prej 13.89% më shumë se në vitin 2007, vlera e të cilit kapë shifrën 422.49 milion ton.

Tab 8a. Importi i naftës dhe derivateve të sajë në baza mujore (në mijë) t 2004-2008

Vitet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2004	27.511,0	25.774,1	28.871,6	28.169,0	23.977,3	23.854,2	26.955,0	29.051,3	27.832,4	33.907,5	52.078,8	35.564,4
2005	24.522,5	21.424,1	28.092,8	29.467,1	29.907,3	29.143,7	33.105,6	34.631,6	29.883,8	33.108,0	29.775,7	29.877,4
2006	20.128,0	26.453,7	24.172,1	28.931,4	27.332,2	24.810,1	29.663,7	36.522,0	33.714,5	30.965,5	35.224,0	39.580,2
2007	27.496,8	24.954,1	34.550,0	27.827,4	25.968,7	29.773,9	33.082,4	38.964,7	34.737,4	30.723,6	29.798,8	33.084,1
2008	34.026,2	30.280,0	31.756,2	34.390,9	36.940,6	32.221,5	34.927,5	38.139,5	33.500,7	40.180,3	34.611,3	41.521,5

Burimi: Statistikat e Tregtisë së Jashtme - ESK

Pika minimale e importit të Naftës dhe derivateve të saja ka qenë në shkurt të 2005 ku janë importuar 21.52 milion ton , kurse ajo maksimale ka qenë në tetor 2004 ku janë importuar 52.07 milion ton Naftë dhe derivate të saja.

## 8 Eksporti i energjisë


Eksporti i energjisë elektrike paraqet sasinë e energjisë elektrike të shitur jashtë shtetit. Sasia mesatare e eksportit të energjisë elektrike nga vitet 2002-2008 është 313,4 mijë GWh.

**Tab 9. Eksporti i energjisë elektrike në GWh dhe norma vjetore e eksportit nga viti në vitë**

Vitet	Eksporti i energjisë elektrike në GWh	Norma e eksportit të energjisë elektrike nga viti në vit (%)
2002	648,1	-
2003	277,6	-57,16%
2004	194,7	-29,88%
2005	225,8	15,97%
2006	253,3	12,20%
2007	359,9	42,09%
2008	235	-34,71%

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 9. Eksporti i energjisë elektrike**



Nga tabela shihet se eksporti i energjisë elektrike për vitin 2002 është 648.1 GWh, ku edhe ka qenë shuma më e madhe e eksportuar në periudhën kohore 2002-2008. Në vitin 2003 shuma e eksportuar është 277.6 GWh apo 57.16% më e vogël se në vitin 2002. Në vitin 2004 kemi të eksportuar 194.6 GWh apo 29.88% më pakë se në vitin 2003. Në vitin 2005 kemi një rritje të eksportit për 15.97% më shuma se në vitin 2004 apo 225.7 GWh.

Në vitin 2006 kemi të eksportuar 253.3 GWh, ose 12.20% më shumë se në vitin 2005. Në vitin 2007 po ashtu shihet një rritje për 42.09%, që është 359.9 GWh. Në vitin 2008 kemi një rënje të eksportit në 234.9 GWh apo 34.71% më pakë se në vitin 2007.

Sasia më e madhe e eksportuar ka qenë në vitin 2002 vlera e të cilit kap shifrën 648.1 GWh, kurse vlera më e vogël e importuar ka qenë në vitin 2004, vlera e të cilit kap shifrën 194.6 GWh.

**Tab.9a Eksporti i energjisë elektrike në baza mujore në GWh (2002-2008)**

Vitet	Muaj	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
2002		59,7	64,7	55,5	134,8	119,8	138,9	47,9	0,0	11,9	8,8	0,0	6,2	648,1
2003		0,0	0,0	1,2	13,9	77,7	71,4	33,2	16,6	21,6	17,3	3,6	21,1	277,6
2004		18,5	3,4	12,2	0,5	2,0	8,5	21,9	18,0	19,6	70,5	19,7	0,0	194,7
2005		10,2	5,0	7,5	3,3	8,2	40,6	60,1	17,7	17,9	32,8	17,8	4,8	225,8
2006		3,1	3,3	4,2	12,9	3,3	12,9	104,2	38,0	38,1	15,0	14,3	4,2	253,3
2007		5,6	13,7	11,8	40,1	120,9	82,9	18,0	36,4	3,8	21,8	3,7	1,3	359,9
2008		0,1	0,1	14,8	29,4	20,0	21,4	36,5	4,5	40,6	40,4	23,8	3,6	235,0

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)


## 9 Prodhimi importi dhe humbjet e energjisë elektrike

**Tab 10. Prodhimi, importi, eksporti dhe humbjet e energjisë elektrike në GWh (2002-2008)**

Vitet	Prodhimi I energjisë nga TC dhe HC	Importi	Eksporti	Konsumi	Humbjet
2002	3151,8	816,0	648,1	1950,6	1369,1
2003	3221,0	637,3	277,6	2041,0	1539,6
2004	3481,1	650,6	194,7	2139,2	1797,8
2005	4003,6	490,6	225,8	2109,3	2159,1
2006	3997,9	537,8	253,3	2155,1	2127,3
2007	4333,0	623,4	359,9	2391,4	2205,1
2008	4528,1	647,5	235,0	2940,9	1999,7

Burimi: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

**Graf 10. Prodhimi, importi, eksporti dhe humbjet e energjisë elektrike në periudhën kohore 2002-2008**



Nëse bëhet krahasimi i zërave brenda grafikut shohim se trendët janë pozitiv. Kemi një ngritje të konsumit e që përcillet me ngritje të prodhimit nga TC dhe HC. Gjithashtu kemi një rënie të vazhdueshme importit dhe të humbjeve si rezultat i një menaxhimit në përmirësim

## 10 Hidrocentralet

Edhe pse Kosova ka kapacitete për ndërtimin e HC nëpër regjione, për momentin funksionojnë tri HC si : HC i Radavcit, HC Ujmanit dhe HC i Lumbardhit.

Pasi që në Kosovë prodhimi primar i energjisë elektrike është përmes thëngjillit apo TMC atë herë edhe në këtë publikim vëmendje e veçantë ju ka dhënë TMC-ve, duke mos i anashkuar edhe HC.

Kapaciteti instalues i Hidrocentraleve është :


- HC " Radavc" ka startuar në vitin 1934. Fuqia instaluese e tij është 2 X 0.17 MW
- HC "Ujman" ka startuar në vitin 1981. Fuqia instaluese e tij është 2 X 17.5 MW
- HC "Lumbardh" ka startuar në vitin 2005. Fuqia instaluese e tij është 2 X 4.12 MW

**Tab 11. Prodhimi i energjisë elektrike prej HC në (në mijë) GWh (2005-2008)**

<i>Vitet</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>
HC " Radavci "	0,7	0,9	0,8	0,7
HC"Ujman"	109,7	99,6	69,6	53,3
HC " Lumbardh "	3,2	26,6	22,8	21,6
<b>Totali I prodhimit</b>	<b>113,5</b>	<b>127</b>	<b>93,2</b>	<b>75,7</b>

Nga Tabela 11 , nëse shikohet totali i prodhimit të energjisë elektrike shohim se kemi pasur një pasqyrë me sa vijon: Në vitin 2005 kemi pasur një prodhim prej 113.5 GWh, në vitin 2006 kemi pasur një rritje të prodhimit prej 11.9% . kure në vitin 2007 kemi pasur një zvogëlim të prodhimit prej 26.6% në raport me vitin 2006, po ashtu rënie të prodhimit kemi pasur edhe në vitin 2008 në raport me vitin 2007 për 18.8%.

**Graf 11. Prodhimi i energjisë elektrike prej Hidrocentraleve (2005-2008)**



Tab 12. Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese nga Hidrocentrale (2005-2008)

<i>Vitet</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>
<b>Totali I prodhimit në GWh</b>	<b>113,5</b>	<b>127</b>	<b>58,1</b>	<b>47,3</b>
<b>Shfrytëzimi I kapaciteteve</b>	<b>70,90%</b>	<b>79,40%</b>	<b>58,10%</b>	<b>47,30%</b>

Gjatë periudhës 2005-2008 shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese në Hidrocentrale patë një rritje në vitin 2006. Në vitin 2007 shkalla e shfrytëzimit patë një rënie të madhe. Rënia vazhdoi të thellohet edhe në vitin 2008. Faktor kyç në këtë rënie ishte thatësia gjatë periudhës përkatëse.

Tab. 12 Bilanci i energjisë elektrike 2005-2008

	2005		2006		2007		2008	
	GWh	%	GWh	%	GWh	%	GWh	%
<b>Prodhimi në disp.</b>	4.494,30	100	4.535,70	100	4.956,40	100	5.175,60	100
<b>Prodhimi Vendor</b>	4.003,70	89,1	3.997,90	88,1	4.333,00	87,4	4.528,10	87,5
Termocentralet	3.890,20	86,6	3.870,90	85,3	4.274,90	86,3	4.480,80	86,6
Hidrocentralet	113,5	2,5	127	2,8	58,1	1,2	47,3	0,9
<b>Import</b>	490,6	10,9	537,8	11,9	623,4	12,6	647,5	12,5
<b>Përdoruesit</b>	2.335,20	52	2.408,40	53,1	2.751,30	55,5	3.175,90	61,4
<b>Konsumi Vendor</b>	2.109,40	46,9	2.155,10	47,5	2.391,40	48,2	2.940,90	56,8
Amvisnit	1.447,90	32,2	1.458,60	32,2	1.503,50	30,3	1.666,90	32,2
Komerçiale	661,5	14,7	696,5	15,4	887,9	17,9	1.274,00	24,6
<b>Eksport</b>	225,8	5	253,3	5,6	359,9	7,3	235	4,5
		0		0		0		0
<u>Humbjet në rrjet*</u>	2.159,10	48	2.127,30	46,9	2.205,10	44,5	1.999,70	38,6

\* Në këtë kategori përfshihen humbjet në rrjet dhe keqpërdorime.

## 11 KEK-u (Korporata Energjetike e Kosovës)

Termocentralet gjenden në komunën e Obiliqit dhe janë vetëm pak kilometra nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina. Kosova A dhe Kosova B së bashku kanë një kapacitet të instaluar prej 1478 MWh ,ndonëse të dy termocentralet prodhojnë shume më pak se kapacitetet e instaluar ( ndërmjet 645 de 710 MWh ) .Së bashku prodhojnë mbi 95 %\_të prodhimit vendor të energjisë elektrike , ndërsa pjesa tjetër furnizohet nga hidrocentrali 35 megavatësh dhe dy hidrocentrale të tjera të vogla qe furnizojnë në mënyre të drejtpërdrejtë sistemet lokale të shpërndarjes. Përveç kësaj Kosova importon energji elektrike nga shtetet fqinje në rajonin e Ballkanit

### **Kapacitetet Aktuale Prodhuese**

#### **Termocentrali „Kosova A“ dhe „Kosova B“**

*Për momentin, kapacitetet prodhuese të blloqeve të ndryshme të dy termocentraleve dhe dy mihjeve sipërfaqësore janë:*

TC "Kosova A" (5 blloqe) me fuqi maksimale aktuale prej 442 MW

- A<sub>1</sub> Fuqua max. 34 MW
- .A<sub>2</sub> fuqia në disp.0 MW<sup>2</sup>
- A<sub>3</sub> Fuqua max.135MW.
- A<sub>4</sub> Fuqua max.135MW
- A<sub>5</sub> Fuqua max. 138MW<sup>3</sup>

TC"Kosova B" (2 blloqe) me fuqi aktuale prej (2X 250 MW)

- B<sub>1</sub> Fuqua max.250MW
- B<sub>2</sub> Fuqua max.250MW
- M.S. Mirash kapaciteti në disponim është 3.65 mili. ton në vit .kurse,
- M.S. Bardh kapaciteti në disponim është 3.40 mili. ton në vit.

---

<sup>2</sup> Për shkak të dëmtimeve të rend blloku A<sub>2</sub> është ndalur në vitin 1998 dhe nuk është aktivizuar më. Dr. sci. Sabri Limari, inxh. i dipl: "Karakteristikat e Konsumit Elektroenergjetik të Kosovës për periudhën qershor1999-dhjetor 2000" ( studim në dorëshkrim)

<sup>3</sup> Po aty .Blloku A<sub>5</sub> ka qenë në prodhim vetëm 3 muajt e pare të vitit 2000.



## Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

**Enti i Statistikës së Kosovës**, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Enti i Statistikës së Kosovës** vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

**Struktura organizative e ESK-së**, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat: Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111**  
**Drejtori: +381 (0) 38 235 545**
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: [ekonomik@ks-gov.net](mailto:ekonomik@ks-gov.net)**
- **Ueb-faqe: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)**